



**Krifca: Privilegj të isha Ministre e Bujqësisë, mirënjohëse ndaj Kryeministrit Rama**

Faqe 4



**Ministrja me peshkatarët në Shirokë: Liqeni, gjenerues punësimi, turizmi dhe zhvillimi ekonomik**

Faqe 6



**Bashkimi European mbështet gratë në sipërmarrje**

Faqe 2



# AGROBIZNESI



Rr. "Qemal Stafa", P. 9-katësh, Nr. 70, Kati 2, Pazari i ri, Tiranë.  
Tel: +355 4 2 251 910 /911  
Email: info@fedinvest.al  
kontakt@fedinvest.al  
www.fedinvest.al

## BOTIM I KËSHILLIT TË AGROBIZNESIT SHQIPTAR

Adresa: Rruga "Mine Peza", Pallati 87/3, Hyrja 1, Kati i parë, Tel/ Fax: 2229445  
E-mail: infokash@yahoo.com www.kash.org.al

15-ditëshi i parë i muajit shtator 2023

**Viti i shtatëmbëdhjetë i botimit - Nr. 469**  
Çmimi 125 lekë

E përdyjavshme e pavarur

# FONDET IPARD TË BASHKIMIT EUROPIAN PËR SHQIPËRINË

## KREU I KASH-IT, RRAPAJ, PËR MEDIAN: FONDET E PROGRAMIT IPARD TË FINANCUAR NGA BASHKIMI EUROPIAN DHE QEVERIA SHQIPTARE, PËR ZHVILLIMIN E BUJQËSISË NË SHQIPËRI, JANË TË NJË RËNDËSIE TË VEÇANTË

*Kryetari i Këshillit të Agrobiznesit Shqiptar (KASH), Agim Rrapaj, në një intervistë për mediat theksoi: "Disbursimi total i fondeve të Programit IPARD II, është një histori suksesi në bujqësinë shqiptare." Ai u ndal në impaktin e programit në sektorin rural teksa theksoi: "Cilido që nuk zbaton kontratat të kthejë fondet, kushdo që abuzon me detyrën të ndëshkohet pa hezitim."*

Intervistë me Z. Agim Rrapaj, Kryetar i KASH

### RISI ALBANIA NJË PROJEKT I AGJENCISË ZVICERANE SDC

#### Mbështetja zvicerane nga arsimit profesional tek turizmi rural

*Ekspertë nga shkolla zvicerane prestigjioze e mikpritjes École hôtelière de Lausanne EHL Group po asistojnë autoritetet shqiptare se si arsimit profesional mund të kontribuojë për turizmin*



Qeveria Zvicerane kontribut për zhvillimin rural në Shqipëri



Faqe 2



### REPORTAZH



**Kina, Hi Tech në Tokën e Qytetërimit të Lashtë - Shqip**  
**China, Hi Tech In The Land Of Ancient Civilization - English**

Faqe 11, 12

### KËNDI I EKSPERTIT

- Fermerët, investime për uljen e riskut nga dëmtimet atmosferike Fq.10
- "Në fshat 2", MBZHR: 24 studentë do të eksplorojnë 4 fshatra duke jetuar e punuar aty për 2 javë Fq.6
- AKU, trajnime për inspektorët e ushqimit në qarqe Fq.5
- Krahina e Oparit - Vatër e origjinës së shumë specieve bimore Fq.13

### AGROTURIZËM

**AKT, bashkëpunim me agjencinë zvicerane për eksperiencat më të mira në turizëm**

Faqe 7

**Ministrja Denaj: Çojmë përpara vizionin për bujqësi drejt standardeve evropiane**



Faqe 2

### DIGJITALIZIM

**WEB-GIS në e-Albania, lehtësi për fermerët të mbjellin kulturën e duhur në tokën e duhur**



Faqe 4



## RISI ALBANIA

## AKTUALITET

# Mbështetja zvicerane nga arsimiti profesional tek turizmi rural

*Ekspertë nga shkolla zvicerane prestigjioze e mikpritjes École hôtelière de Lausanne EHL Group po asitajnë autoritetet shqiptare se si arsimiti profesional mund të kontribuojë për turizmin*

Arsimi profesional, mbetet një nga mundësitë më të mira për punësimin e të rinjve, që zgjedhin të profilizohen në fusha të ndryshme, por veçanërisht në profilet e shërbimeve, siç është Hoteleri-Turizmi, një nga degët më të kërkuara në industrinë e turizmit, e cila po zhvillohet me ritme të shpejta në Shqipëri. Programet e mbështetura nga qeveria zvicerane përmes projektit RisiAlbania në këto vitet

regjistruar për të ndjekur arsimin e mesëm në 35 shkollat profesionale në të gjithë vendin, ndërsa regjistrimet në klasë të dhjetë janë hapur deri më datë 30 shtator, përmes e-Albanias.

Drejtori i përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (AKPA), Klevis Hysa, bën të ditur se 16 % e numrit të përgjithshëm të nxënësve të regjistruar në klasë të 10-të janë vajza.

më të kërkuara edhe këtë vit kanë qenë Teknologjia e Informacionit (IT) dhe Hoteleri-Turizmi, ndjekur nga të gjitha drejtimet e tjera teknike.

Sipas tij, një rritje të lehtë ka edhe bujqësia, në të gjithë profilet e saj.

Kreu i AKPA-së thekson se përveç arsimit të mesëm profesional, këtë vit po i kushtohet një vëmendje e veçantë edhe drejtimeve pas të mesmes, për të mbuluar kështu më mirë nevojat për kualifikime profesionale në të gjitha nivelet.

“Në tetor do të fillojnë regjistrimet në arsimin pas të mesëm i cili do të ofrohet në 4 profile në 8 shkolla të arsimit profesional, në 7 bashki të vendit: Tiranë, Elbasan, Lezhë, Vlorë, Korçë, Berat dhe Sarandë”, u shpreh Hysa.

Arsimi profesional është rruga e sigurt drejt punësimit real, ndaj dhe qeveria shqiptare po mbështet me politika të veçanta kualifikimin e fuqisë punëtore në përputhje



e fundit, kanë dhënë rezultate pozitive nga arsimiti profesional e deri tek turizmi rural.

Ndërsa turizmi në Shqipëri rritet, ka nevojë të përmirësohen kapacitetet profesionale në këtë sektor. Këtë javë ekspertë nga shkolla zvicerane prestigjioze e mikpritjes École hôtelière de Lausanne EHL Group po asitajnë autoritetet shqiptare se si arsimiti profesional mund të kontribuojë për turizmin. “Pres me interes të shoh një plan pune të përcaktuar mirë nga projekti i EHL për arsimin profesional dhe eventualisht një qendër ekselence të arsimit profesional e cila do t'i shtojë vlerë sektorit të turizmit në Shqipëri” – tha Ambasadorja zvicerane Ruth Huber.

**Arsimi profesional, Hysa: Janë regjistruar mbi 4200 nxënës, 16% janë vajza**

Mbi 4200 nxënës janë

“Numri i nxënësve të regjistruar në arsimin e



mesëm profesional është në rritje. Aktualisht deri me tani janë regjistruar në klasë të dhjetë mbi 4200 nxënës ose 5 % me shumë se në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Interes në rritje për të ndjekur një nga 22 degët e studimit që ofron arsimiti profesional kanë patur vajzat, që përbëjnë 16 % të totalit të të regjistruarve”, deklaroi Hysa.

Hysa bën të ditur se degët

me nevojat e tregut të punës.

Të dhënat tregojnë se mbi 57 % e punëkërkuësve me arsim profesional hyjnë në punë që vitin e parë, pas përfundimit të edukimit.

Në 35 shkollat profesionale në të gjithë vendin janë përfshirë 22 drejtime mësimore, 87 profile profesionale kryesisht në hoteleri-turizëm, shkenca kompjuterike, shkenca mekanike, tekstile, etj.

# Ministrja Denaj: Çojmë përpara vizionin për bujqësi drejt standardeve evropiane

Pas betimit në Presidencë, në 13 shtator Anila Denaj ka marrë zyrarisht detyrën e ministres së

Në ceremoninë zyrtare të dorëzimit të detyrës ishte e pranishme zëvendëskryeminstrija



Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Në takim të organizuar me këtë rast në ambientet e MB-ZHR-së, ministrja Denaj u prit nga ish-ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca dhe titullarët e institucioneve të varësisë e drejtues të tjerë.

Belinda Balluku.

Në fjalën e saj, Krifca vlerësoi punën e stafit të Ministrisë së Bujqësisë dhe vuri në dukje se arrijtjet në disa prej prioritetëve të punës së institucionit, janë rezultat i kontributit të të gjithëve. Ajo shprehu vlerësimet më

të larta për ministren Denaj dhe njëherësh i uroi asaj suksese në detyrën e re, duke i dorëzuar edhe një dosje me arrijtjet, prioritetet dhe objektivat e ardhshme.

Anila Denaj, në detyrën e ministres së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, falënderoi Krifcën për punën e bërë dhe shprehu angazhimin për vijimin e punës me prioritetet që ajo ka vendosur në detyrën e sapomarë.

“Në prezantimin me stafin drejtues të këtij institucioni me zvkryeminstren Belinda Balluku, ku theksuam vijimin e punëve të mira të qeverisë shqiptare në shërbim të fermerëve, prodhuesve e të gjithë aktorëve në zinxhirin e vlerës agrourbano-rurale”, u shpreh Denaj.

“Falënderime për punën e ministres Frida Krifca dhe të gjithë personelit të dedikuar, me të cilët do të çojmë përpara vizionin për një bujqësi të fortë, të qëndrueshme, drejt standardeve evropiane”, tha Denaj.

# BE mbështet gratë në sipërmarrje

Tetë vjet më parë, kur Ejona Zaimaj nisi përpjekjen e guximshme për të krijuar “Amalthia Farm”, një fermë dhish, vizioni i saj u ndesh me skepticizëm nga të gjitha anët.

Megjithatë, sot ajo është një sipërmarrëse e suksesshme blegtorale dhe bujqësore, me një tufë të lulëzuar prej rreth 350 dhish nën kujdesin e saj

Quest, mbështetur nga BE.

Së bashku me gra të tjera sipërmarrëse nga e gjithë Evropa dhe Azia Qendrore, ajo mori pjesë në kampe trajnimit për të përmirësuar aftësitë e saj të biznesit dhe mori mentorim të përshtatur nga ekspertë të njohur të investimeve.

Programi i mbështetur nga BE, synon të forcojë rolin e

vlerat thelbësore të përfshirjes, diversitetit dhe të mos lënit askënd pas. Expo përfshin një sërë aktivitete për ngritjen dhe rrjetëzimin e bizneseve vendore dhe ndërrajonale, si dhe seminare për ngritjen e kapaciteteve që u japin mundësi bizneseve, investitorëve/eve dhe grave sipërmarrëse të rajonit të rrjetëzohen dhe të mësojnë nga palët e tjera.

Expo 2023 do të kulmojë me një event virtual live me mundësi shkëmbimi dhe rrjetëzimi me investitorë/e.

Për t'u kualifikuar për të gjitha fazat e Expo-s, gratë sipërmarrëse ose që përfaqësojnë një biznes në pronësi të grave, duhet të kenë një produkt minimal të mjaftueshëm për t'u përdorur nga klientët; në fazë shitjesh ose të jeni në fazën e rritjes (që gjenerojnë të ardhura).

EXPO Virtuale Rajonale 2023 do të zhvillohet në nëntor 2023 dhe do të jetë e hapur për të gjitha gratë sipërmarrëse të interesuara. Gratë e përzgjedhura do të ftohen të marrin pjesë në Bootcamp/Trajnime dhe Eventet Satelit, të cilat ndryshojnë nga shteti në shtet.



dhe një biznes në zgjerim të bletëve.

Ajo po kërkon në mënyrë aktive mundësi për të zgjeruar fushën e saj të punës dhe këtë vit ajo ishte një nga 23 gratë që morën pjesë në iniciativën e UN Women EXPO Capital

gruas në sipërmarrje përmes ndërveprimeve mes tyre, me qëllim zgjerimin e biznesit dhe bashkëpunimit mes tyre.

Kështu “Expo 2023” mbledh bashkë gra sipërmarrëse dhe partnere biznesi nga Evropa dhe Azia Qendrore, bazuar në

# Prezantohet në Lushnje Projekti: "Agro-Sipërmarrja, një koncept efikas për rritjen të qëndrueshme dhe bujqësi të orientuar drejt tregut"

projektit: "Agro-Sipërmarrja, një koncept efikas për rritjen të qëndrueshme dhe bujqësi të orientuar drejt tregut" organizoi këtë takim me mbështetjen e Bashkisë Lushnje me qëllim krijimin e një mjedisi të favorshëm për përfshirjen aktive të të rinjve në zhvillimin e sektorit bujqësor dhe agro-turistik, si dhe orientimin e tyre drejt shkollave profesionale.



Në këtë takim u pasqyruan avantazhet në terren dhe në politika mbështetëse, ku potenciali i Qarkut Fier në produktet bujqësore në vitin 2022 ishte 534.351 ton (në vënd të parë në Shqipëri) sipas të dhënave statistikore të INSTAT.

Meqenëse bujqësia varet kryesisht nga shërbimet e ofruara nga ekosistemet, bujqësia e qëndrueshme synon të zvogëlojë ndikimet negative antropogjene në mjedis, përmes përdorimit efikas, ruajtjes dhe përmirësimit të cilësisë së burimeve natyrore.



## INTERVISTA

## FONDET IPARD TË BASHKIMIT EUROPIAN PËR SHQIPËRINË

# KREU I KASH-IT, RRAPAJ, PËR MEDIAN: FONDET E PROGRAMIT IPARD TË FINANCUAR NGA BASHKIMI EUROPIAN DHE QEVERIA SHQIPTARE, PËR ZHVILLIMIN E BUJQËSISË NË SHQIPËRI, JANË TË NJË RËNDËSIE TË VEÇANTË

*Kryetari i Këshillit të Agrobiznesit Shqiptar (KASH), Agim Rrapaj, në një intervistë për mediat theksoi: “Disbursimi total i fondeve të Programit IPARD II, është një histori sukse si në bujqësinë shqiptare.” Ai u ndal në impaktin e programit në sektorin rural teksa theksoi: “Cilido që nuk zbaton kontratat të kthejë fondet, kushdo që abuzon me detyrën të ndëshkohet pa hezitim.”*

Intervistë me Z. Agim Rrapaj, Kryetar i KASH

**Nuk ka ende një vendim përfundimtar për hetimet nga Zyra e OLAF, por është mësuar se AZHBR ka dërguar kërkesa për disa përfitues të programit IPARD II të cilët duhet të kthejnë mbrapsht fondet e përfituara.**

**Z. Rrapaj, çfarë ka ndodhur saktësisht?**

Kërkesa për kthim fondesh nuk është një procedurë që ka nisur tani, por shumë kohë më parë. Në bazë të kontrolleve që janë bërë, disa nga subjektet të cilat nuk u janë përmbajtur kontratës u është kërkuar të kthejnë fondet mbrapsht. Kjo është një procedurë normale, pasi midis AZHBR-së dhe përfituesit është një kontratë 5-vjeçare ku janë shkruar disa detyrime që përfituesi duhet t'u përmbahet, për të mos dalë jashtë objektivave për të cilat janë dhënë këto fonde. Ky nuk është një lajm i ri, por është një procedurë që është ndjekur edhe më parë dhe do vijojë edhe në të ardhmen. Rastet kur kërkohet kthimi i fondeve janë disa si psh: Mosmbyllja në kohë e investimit ose dalja jashtë objektivave për të cilat janë marrë këto fonde, janë shkelje të kontratës. Në momentin që nga kontrollat në terren konstatohen të tilla shkelje, ndodh edhe kërkesa për kthimin e fondeve.

**Këto parregullsi janë përgjegjësi vetëm e përfituesve apo dhe e AZHBR-së, e cila duhet t'i njoftojë apo t'i ndjekë hap pas hapi për të gjitha proceset që ata kryejnë?**

Procesi i informimit dhe ndërgjegjësimin të përfituesve është një nga detyrat e AZHBR-së, e cila është e detyruar t'i informojë ata mbi rastet për kthimin e fondeve sipas detyrimeve në kontratë. AZHBR monitoron procesin, u dërgon shkresa njoftuese periodikisht subjekteve përfituese, për t'i rikujtuar zbatimin e detyrimeve kontraktuale. Arsyet përse nuk është mundësuar nga përfituesi realizimi i kontratës janë të ndryshme dhe ky është një proces që përfundimisht zgjidhet në gjykatë, nëse përfituesi nuk është dakord me vendimin e marrë nga AZHBR.

**Si kanë rezultuar këto raste, është pranuar vendimi i AZHBR-së apo çështja është dërguar në gjykatë?**

Ka pasur raste që është pranuar njoftimi dhe fondet janë kthyer vullnetarisht, por ka raste që nga përfituesit edhe është kundërshtuar në gjykatë, janë paraqitur prova e dokumente, janë dhënë argumenta dhe është gjykata ajo që jep vendimin final.

**Z. Rrapaj ka disa hapa për të arritur në kërkesën finale për kthimin e fondeve mbrapsht?**

Sigurisht që ka disa hapa që ndiqen në këto raste. Hapi i parë është kontrolli dhe ballafaqimi i palëve, evidentohen shkaqet se përse kanë ndodhur parregullsitë, gjykohet në instancat përgjegjëse çfarë mase do të merret dhe në varësi të masës, çështja mund të kalojë në gjykatë, nga AZHBR kur përfituesi refuzon kthimin e fondeve, ose nga përfituesi kur nuk bie dakord me vendimin për kthim fondesh nga AZHBR.

**Çfarë po ndodh me përfituesit IPARD II të thirrjeve të fundit, pas hetimit nga Zyra Evropiane Antimashtrim (OLAF) dhe ngrirjes së fondeve?**

Hetimi si proces nga ekspertët e zyrës OLAF ka mbaruar, raporti është dorëzuar në instancat përkatëse superiore të OLAF dhe po vlerësohet nga eprrorët e tyre. Zyrtarisht nuk kemi dijeni për rezultatet e kontrollit, pasi ato do të vijnë të shkruara nga institucioni përgjegjës që është Zyra për Bujqësinë në Komisionin Evropian. Gjithashtu ne dimë që vlerësimi i aplikimeve të përfituesve nga programi IPARD II nuk është pezulluar, pasi vazhdon procesi vlerësimin të aplikimeve që janë në proces. Ajo që është pezulluar është një faturë disbursimi, rreth 430 mijë euro, por vlerësimi për aplikimet e tjera vazhdojnë. IPARD është një program madhor që asiston financiarisht fushën e Ekonomisë së Ushqimit, që ndihmon të gjithë sektorët në tërësi dhe jo vetëm projektet individuale, është një program që ndihmon zhvillimin në të gjithë vendin, për ta përgatitur drejt anëtarësimin në Bashkimin Evropian.

**Sot, nisma “Thurje” ka bërë një kallëzim në SPAK për ish-ministren Krifca dhe zyrtarë të tjerë të AZHBR-së me pretendimin që mund të kenë abuzuar. Mbi cilët mbetet përgjegjësia nëse verifikohet që ka pasur shkelje në zbatimin e këtij programi?**

Ne do të presim edhe pak ditë për të marrë përgjigje nga raporti i OLAF. Gjetjet do të analizohen rast pas rasti dhe do të dalin edhe përgjegjësit për çdo parregullsi, kështu edhe pyetja juaj do të marrë përgjigje se kush e ka përgjegjësinë. Nuk është e thënë që të gjitha ato që thuhet në kafene, që shkruhen

mi Evropian e ka rriskun zero për kthimin e fondeve sepse i ka të garantuara fondet e Programit IPARD nga buxheti i shetitit shqiptar.

**OLAF ka kryer hetime edhe për vende të tjera të cilat janë në proces si Shqipëria, por për vendin tonë është rasti i parë i bërë publik në përmasa të tilla. Sipas informacioneve që ju keni, si ka qenë vendimarrja në të tilla raste?**

Për Shqipërinë me sa kujtoj është bërë një kontroll para disa viteve për projekte të financuara me fondet IPA, por jo në fushën e bujqësisë dhe

Nëse ka gabuar përfituesi, do jetë ai që do të paguajë.

Flitet shpesh që fondet e Bashkimit Evropian janë për fermerët, ky nuk është një konceptim tërësisht i saktë. Ne kemi mbi 300 mijë fermerë, pjesa më e madhe të paformalizuar, por edhe ata të pajisur me NIPT nuk përfitojnë sepse nuk njihet si dokument identifikimi, duhet të kenë gjithë sasinë e fondeve për të realizuar investimin. Cilët nga fermerët tanë të paisur me NIPT i kanë në dispozicion të gjitha këto fonde dhe të kualifikohen për lidhje kontrate?

MBZHR nuk janë dobiprurëse, veçanërisht të ndërrosh disa herë të njëjtin drejtues institucioni, që zbaton edhe projekte me donatorë brenda një periudhe të shkurtër kohe, kjo reflekton paqëndrueshmëri dhe e frenon procesin e disbursimit të fondeve. Natyrisht që ndryshimet bëhen për të rritur efektivitetin, por ta argumentoj rastin konkret pse ka ndodhur, nuk është as detyra ime dhe nuk janë as motivet pse po ndodh ndryshimi. Ministja Krifca sipas mendimit tim ka bërë një punë shumë të mirë për disbursimin e fondeve dhe zhvillimin e sektorit.

Përsa i përket të ardhmes, mendoj se ecuria në fushën e Ekonomisë së Ushqimit nuk do të varet nga një dorë e vetme, por u përket të gjithëve. Besoj se znj. Denaj ka eksperience në drejtim, do të zgjidhë disa probleme që nuk janë zgjidhur më parë, mendoj se do të jetë më këmbëngulëse që MBZHR të ketë buxhetin që nevojitet, për të pasur paketën fiskale që duhet, skema subvencionimi, si edhe për të zhbllokuar këtë situatë që është krijuar me fondet e IPARD-it, sa më shpejt që të jetë e mundur. Ajo është në profesionin e vet, ka njohuri të plota për këto çështje dhe sigurisht që kërkohet punë dhe bashkërendim.

Çështja është e tillë që të mos improvizojmë gjëra të paqena, por të drejtohem siç duhet, përmes rrugëve ligjore. Besimin që na ka dhënë BE-ja nuk duhet ta hedhim poshtë.

**Kur diskutohet hapja e programit IPARD III?**

Sapo të vijë raporti nga zyrat e BE-së dhe të përfundojnë procedurat zyrtare të vlerësimin. Nuk mendoj se do të vonojë edhe për shumë kohë hapja e programit IPARD III. Gjithashtu mendoj se procesi do të zbatohet me një vështirësi të shtuar në krahësim me më parë, duke u nisur nga klima që është krijuar. Gabime edhe ndodhin, por e rëndësishme është t'i njohim dhe eliminojmë ato sa më parë, të ndëshkohet rreptësisht dhe pa hezitim cilido që do të shpallet fajtor për abuzime me fondet për arsye përfitimesh të padrejta dhe të futemi sa më parë në rrjedhën normale të procesit.



në portale apo në media të jenë të vërteta. Gjetjet e raportit të kontrollit do të vlerësohen edhe nga pala shqiptare, do ballafaqohen me argumentat dhe provat që ka secila palë. Të dyja palët duhet të kenë një proces ballafaqimi për çdo gjetje sepse Zyra për Bujqësinë në KE mund të bindë edhe nga argumentat dhe provat që do të japë pala shqiptare. Tashmë nuk po bëhet fjalë për fatin e disa individëve që nuk kanë zbatuar kontratat, apo disa subjekteve që nuk kanë kryer në mënyrë rigoroze detyrën e kontrollit, por po diskutohet për ecurinë e një programi ndihme që është me shumë rëndësi për integrimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Ne kemi shumë nevojë dhe kërkojmë të disbursojmë pa humbur kohë disa fonde grant nga Bashkimi Evropian dhe nga tjetër është BE-ja që kërkon disa rregulla për disbursimin e këtyre fondeve. Të dyja palët do dëgjojnë njëra-tjetrën për të arritur një konkluzion. Bashki-

ka ndodhur që është pezulluar projekti. Është hetuar procesi, kanë ardhur përfaqësues të BE-së, ku është bërë ballafaqimi, janë dhënë argumentat dhe procesi i disbursimit të fondeve ka vazhduar normalisht, pa marrjen e asnjë mase ndëshkuese. Në këtë rast kishte një mungesë komunikimi për të dhënë argumentat secila palë, edhe tani si palë shqiptare jemi në një situatë ku duhet të japim argumentat tona.

Ne kemi pasur rastin e një fermeri në shoqatën tonë, të cilit i është kërkuar kthimi i fondeve mbrapsht, dhe shkaku ishte mbyllja e NIPT-it, pasi sipas detyrimeve kontraktuale me AZHBR-në duhet të qëndronte i hapur. Fermeri nuk e dinte që mbyllja e NIPT-it do t'i shkaktonte këto pasoja dhe janë dashur një kalvar diskutimesh, pasi nuk pranohej një NIPT i ri dhe ishte e vështirë të rihapej NIPT-i i vjetër.

Hetimet nuk janë për kontratat në proces, por për ata të cilët janë dhënë këto fonde.

Kështu që nuk duhet të mendojmë që po ndëshkohen fermerët, por po ndëshkohen disa subjekte që kanë mundësinë të investojnë por që OLAF pretendon se kanë probleme me zbatimin e kontratave.

Njëkohësisht nuk duhet të harrojmë që po ndëshkohet një proces, ku për mendimin tim procesi i disbursimit të fondeve IPARD ka qenë një histori sukse si, sepse për të gjitha fondet që janë vënë në dispozicion ka pasur projekte për t'i disbursuar dhe jo për 94 milion euro, por për 249 milion euro. Kemi të bëjmë me një kërkesë të madhe për investime, në mënyrë që të mbyllem ato mangësi që kemi në të gjithë sektorët. Në mënyrë indirekte kjo ndihmë shkon zinxhir tek të gjithë fermerët.

**Si i keni parë ju ndryshimet e fundit që janë bërë për drejtimin e MBZHR-së dhe si mendoni se do të vijojë puna?**

Unë mendoj se ndryshimet e shpeshta të drejtuesve në



## INFORMACIONE

## Krifca: Privilegj të isha Ministre e Bujqësisë, mirënjohëse ndaj Kryeministrit Rama

“Këto dy vjet kam pasur privilegjin e jashtëzakonshëm që të shërbej si Ministre e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, një sektor që ndër vite mësova ta dua e t’i shërbej me guxim, vendosmëri, por më së shumti me zemër. Është një privilegj për të cilin do të jem gjithë jetën mirënjohëse ndaj Kryeministrit Rama, Partisë Socialiste dhe qytetarëve që na dhanë besimin e tyre”.

Kështu u shpreh, ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca, në takim me stafin e dikasterit që ajo drejtoi në këto dy vite, post të cilin do ta mbajë Anila Denaj.

“Në fjalën e mbajtur në këtë takim Krifca tha se, ky cikël mbyllet sot për mua me vetëdijen dhe krenarinë që kjo periudhë ka sjellë një realitet të ri, me rezultate konkrete dhe investime të prekshme në bujqësi”.

Krifca solli në vëmendje rezultatet e arritura. “Rritja e ndjeshme e eksporteve me mbi 200 milionë euro në dy vjet, tejkalimi i pritshëm i 600 milionë eurove eksporte në 2023 dhe produktet tona që sot furnizojnë mbi 80 vende në botë, janë kartëvizita e bukur e transformimit epokal që ka ndodhur dhe po ndodh në bujqësinë shqiptare”, shkruan ish-ministrja e Bujqësisë.

“Kemi rritur aksesin në treg për fermerët përmes ngritjes së dhjetëra tregjeve bujqësore në partneritet me bashkitë. Të tilla tregje, të cilët kanë plotësuar nevojat e fermerëve për të tregtuar prodhimet, ulur kostot, nxitur më tej konkurrencën dhe përfitimet për qytetarin. Ndërkohë, rrisim sigurinë financiare përmes projektligjit të ri që nxjerrim në konsultim publik për përdorimin e stokut të magazinuar dhe dëftesave tregtare si kolateral për bankat duke adresuar një nevojë të kahershme të zinxhirit të vlerës”, bën të ditur më tej Krifca.

“Kemi ndërtuar këto vite një segment inegzistent të zhvillimit rural përmes mbështetjes ndaj agroturizmit, shtëpive rurale të shndërruara në bujtina, fermave të diversifikuara, certifikimit dhe mbrojtjes së prodhimeve tradicionale duke motivuar qëndrimin e njerëzve në fshat, ndikuar direkt në ekonominë e vogla familjare duke rritur vlerën e prodhimeve të tyre që tërheqin vizitorë e konsumatorë në zonat më të thella të vendit”, u shpreh më tej ajo.

“Kemi rritur ndjeshëm sipërfaqen e tokës nën ujë, forcuar argjinaturat në mbrojtje nga përmblytjet, modernizuar hidrovorë me teknologji moderne. Përmes programit të ri të financimit negociuar suksesshëm me Bankën Botërore prej këtij viti mundësojmë sisteme inovative ujitje duke çuar ujën me presion në çdo fidan për mijëra fermerë, program që do të sjellë një qasje të re të

përbaljes me ndryshimet klimatike”, evidenton ish-ministrja.

“Transformim i ngjashëm po ndodh e do të vijojë më tej në kantierin e rëndësishëm të sigurisë ushqimore ku me një strategji të qartë, kemi krijuar politika më të forta, të rrepta, kemi zbatuar kontrollet në fer-



ma bujqësore e blegtorale duke respektuar një plan monitorimi të mbetjeve në përputhshmëri të plotë me DG Sante ndërsa kemi punuar fort për ndërtimin e tre ligjeve të reja për shëndetin e kafshëve, bimëve dhe kontrollet zyrtare të përputhura me ‘acquis’, të cilat miratohen në parlament këtë vit duke ndikuar ndjeshëm në mbrojtjen dhe rritjen e qendrueshme të eksporteve”, shkruan Krifca.

“Në muajt në vijim fillon rikonceptimi i pesë pikave hyrëse kufitare me standardet më të larta të sigurisë ushqimore me laboratorë të sofistikuar të cilët do të rrisin ndjeshëm filtrat e sigurisë ushqimore për konsumatorët tanë.

Me qeverinë italiane kemi ndërtuar programin më transformues në sektorin e peshkimit, i cili do të sjellë investime të genësishme në markata, pika zbarrimi përgjatë vijës bregdetare dhe qendra grumbullimi me standarte të larta të sigurisë ushqimore”, nënvizon Krifca.

“Fuqizojmë Institutin e Sigurisë Ushqimore e Veterinarisë duke ofruar një model të ri shërbimi e shpërblyer mundin e shkencëtarëve dhe specialistëve që garantojnë sigurinë ushqimore në vend. Në fokus të punës së përbashkët ka qenë dixhitalizimi dhe transformimi i shërbimeve në bujqësi, një kantier investimi ku puna vijon për më shumë ndërveprim e transparencë. Për herë të parë, për fermerët është krijuar një portal i dedikuar 24/7, i cili ofron në çdo kohë informacion mbi tregun, çmimet, operatorët, shërbimet, mundësitë e financimit dhe mundësitë e zhvillimit të bujqësisë shqiptare”, shton Krifca.

Ish-ministrja solli në vëmendje edhe punën e realizuar në aspektin akademik.

“Frymëzimi i të rinjve në bujqësi dhe ngritja e një partneriteti konstruktiv me Universitetin Bujqësor të Tiranës ku këto dy vite, kemi bërë së bashku, më shumë se ç’është bërë

në tridhjetë vjet, ka mundësuar ndërtimin e programit të partneritetit me Universitetin e BOKU ku qeveria shqiptare angazhohet financiarisht për të mbështetur transformimin e UBT dhe paralelisht kemi realizuar programe efektive trajnimit me profesorët e nderuar

për trupën e bujqësisë, fermerë dhe blegtorë, ndërsa, kemi përzgjedhur ferma të tjera model për ti udhëhequr fermerët e ndihmuar në përmirësimin e produktivitetit dhe efektivitetit. Mbështetëm rihapjen e programit të doktoraturave, ndërsa kemi nxitur e financuar me bursa regjistrimin e studentëve në programet prioritare në bujqësi, veterinar, akuakulturë e peshkim për të siguruar vazhdimësinë e të ardhmes së sektorit”, tha Krifca.

“Promovojmë çdo ditë, pa reshtur, realitete dhe çdo kontribues në bujqësi për t’i dhënë dritën dhe shkëlqimin e duhur sektorit dhe fermerëve, njerëzve, agronomëve, veterinerëve, profesionistëve të sigurisë ushqimore, të apasionuarve të një sektori i cili i jep shumë këtij vendi përmes modeleve të thjeshtësisë së punës së palodhur dhe dashurisë së njerëzve që merren me të.

Të gjitha këto, janë themele solide që kemi ngritur bashkarisht me çdo punonjës të bujqësisë anekënd vendit, me çdo kontribues e dashamirës të sektorit duke punuar fort e me përkushtim, themele mbi të cilat do të vijojë të ngrihet bujqësia”, tha Krifca.

“Në nivel personal, ky cikël mbyllet me vetëdijen që, së bashku me ekipin, skuadrat në territor dhe secilin bashkëpunëtor e kontribues, të cilët gjej rastin t’i përullem e t’i falenderoj me respekt e përzemërsi, kemi arritur të sjellim me përgjegjësi maksimale një impakt real në jetët e qindramijëra qytetarëve.

Dëshiroj të gjithë ata fermerë, të cilët më kanë mirëpritur në shtëpitë, fermat dhe stabilimentet e tyre në çdo skaj të vendit e që kanë ndarë vizionin e tyre, ëndrrat dhe dëshirat për më shumë punë në fshat dhe që kanë gjetur tek Ministria e Bujqësisë e Zhvillimit Rural një partner

(Vijon në faqen 7)

## Finalizohet laborator i parë për fidanët dhe bimët medicinale në Shkodër

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj në kuadër të vizitës në Shkodër,

Denaj ka theksuar se garantimi i sigurisë ushqimore dhe mbrojtja e shëndetit të

ndaj abuzuesve.

Ministrja nënvizon se roli i Autoritetit Kombëtar të Ushqimit është kyç për të mbrojtur shëndetin e konsumatorëve, duke forcuar kontrollet në terren dhe në PIK.

“Monitorimi i punës së inspektoreve do të jetë përgjegjësi e shtuar e strukturave qendrore”, shprehet Denaj në një postim në rrjetet sociale.

Gjithashtu, ministrja vë në dukje se laboratorët e AKU-së janë një investim i rëndësishëm.

Denaj bëri të ditur se është finalizuar laborator i parë për farat, fidanët dhe bimët medicinale në qarkun e Shkodrës nga 5 laboratorë të siguruar falë mbështetjes së Bankës Botërore.



zhvilloi një takim edhe me punonjësit e Drejtorisë Rajonale të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit.

konsumatorëve mbetet fokus në të gjithë vendin, me marrjen e masave për çdo jokonformitet dhe luftën

## Denaj me delegacionin e Senatit çek: Bashkëpunim në bujqësi dhe agroturizëm

Shqipëria dhe Republika Çeke, synojnë zgjerimin e bash-

këpunimit në fushën e bujqësisë midis dy vendeve, me fokus

ritjen e investime, eksporteve dhe në fushën e peshkimit.

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj priti në ambientet e MBZHR, delegacionin e përfaqësuesve të lartë të Dhomës së Senatit të Parlamentit të Republikës Çeke dhe Karel Urban, ambasadorin e Çekisë në Shqipëri.

“Diskutuam për bashkëpunime potenciale që kanë të bëjnë me kulturat bujqësore me avantazh konkurrues të vendit tonë, si dhe aktivitete bujqësore të lidhura me turizmin, siç është agroturizmi dhe peshkimi sportiv”, u shpreh Denaj.



## WEB-GIS në e-Albania, lehtësi për fermerët të mbjellin kulturën e duhur në tokën e duhur

Fermerët, në mbarë vendin, tani e kanë më të lehtë punën e tyre, për mbjelljen e kulturës së duhur në tokën e duhur, falë informacionit të saktë me WEB-GIS, me të dhënat specifike të tokës.

Sistemi i përmirësuar elektronik për të dhënat e tokës bujqësore në Shqipëri, është i aksesueshëm në e-Albania.

Ai i orienton fermerët të mbjellin aty ku toka është më përshatshme, përmes të dhënave dhe informacioneve që gjeneron duke ndihmuar kështu prodhuesit bujqësor, për më shumë efektivitet, prodhimtari, ulje kostosh dhe ulje të ndotjes së mjedisit.

Ekspertët e bujqësisë shprehën se, informacioni WEB-GIS, online në e-Albania është një mundësi më tepër edhe për mbrojtjen e mjedisit dhe minimizimin e erozionit në zonat e rrezikut.

Gjithashtu është një orientim

efikas për përdorimin e plehrave bujqësore dhe për skemat utitëse dhe kulluese. Ai ofron transparencë të plotë të dhënash dhe një hartë digjitale e aksesueshme në

spertëve të fushës, duke i lehtësur ata në marrjen e informacionit dhe orientimin e tyre. Ai është realizuar në bashkëpunim me Ministrinë



çdo kohë për tokat e mbjella.

Ky shërbim i ri i vjen në ndihmë fermerëve dhe ek-

e Bujqësisë, AKSHI-t dhe Qendrës së Transferimit të Teknologjisë Bujqësore



## TEMA TË DITËS

# AKU, trajnime për inspektorët e ushqimit në qarqe

Nisma e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit "Të trajnuarit, trajnojnë" ka vijuar me trajnimin e inspektorëve të Sektorit të Mbrojtjes së Bimëve dhe Inputeve Bujqësore nëpër qarqe.

AKU bën të ditur se, programi i trajnimeve për specialistët e inspektorët e ushqimit në qarqe, janë përgatitur nga sektori pranë Drejtorisë së Përgjithshme të AKU-së në bashkëpunim me Sektorin e Trajnimeve dhe Asistencës Teknike.

Sipas AKU-së, qëllimi kryesor i trajnimeve, të nisura tashmë nga DRAKU Lezhë, është rritja e kapaciteteve tekniko-profesionale të stafit të sektorëve KKMBIB të DRAKU-ve për rifreskimin e bazës

ligjore ekzistuese dhe njihjen me aktet ligjore të reja.

Gjithashtu, në fokus të tra-

procedurat e kontrolleve zyrtare, licencimin dhe marrjen e mostrave në fushën e inputeve



jimeve janë e dhe praktikat më të mira ndërkombëtare për

bujqësore dhe veprimtarisë prodhuese të duhan-cigareve.

# DPD: Importi i drithërave për 7-mujorin arriti 130,351 tonë

Shqipëria importoi 130,351 tonë drithëra gjatë

shkuar. Në vlerë, referuar të dhën-

udhën 7-mujore 5.1 miliardë lekë.

Edhe vlera e importit të drithërave shënoi një rënie me rreth 1.7 miliardë lekë, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2022.

Sasia më e lartë e importit të drithërave për 5 vitet e fundit u regjistrua në vitin 2020, që përkon me periudhën e pandemicë së COVID-19.

Gjatë 7-mujorit janar-korrik 2020 u importuan 219,499 tonë drithëra.

Ministria e Bujqësisë për të nxitur kultivimin e grurit në vend ndërmori një fushatë dukë ofruar mbështetje financiare prej 30 mijë lekësh për hektarë për sipërfaqe jo më pak se 1 hektar.



7-mujorit të këtij viti, ose rreth 5,000 tonë më pak se në të njëjtën periudhë të vitit të

nave të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, importet e drithërave llogariten për peri-

# FOKUS - BE i jep fund kufizimeve të importit për produktet e grurit ukrainas

Komisioni Evropian mbështeti vendimin për t'i dhënë fund kufizimeve të importit për produktet e grurit ukrainas, ndërsa theksoi nevojën për të zhvilluar bisedime për këtë, pasi tri vende të BE-së pritet të kundërshtojnë masën.

Kontrollet mbi grurin ukrainas që kufizuan importet në Bullgari, Hungari, Poloni, Sllovakia dhe Rumania përfunduan në mesnatë, pas një vendimi të komisionit të premtën.

Si përgjigje, Polonia, Hungaria dhe Sllovakia thanë se kishin planifikuar të ruanin kontrollet, nga frika e një tepriçë të produkteve të grurit ukrainas dhe rënies së çmimeve.

"Ne kemi nevojë për rrethana të jashtëzakonshme për të justifikuar këtë lloj kufizimi, dhe për momentin shohim se nuk ka asnjë përçarje apo shtrembërim në tregun e këtyre pesë vendeve anëtare", tha nënkryetari i Komisionit të

BE-së, Valdis Dombrovskis. "Komisioni do të monitorojë situatën dhe do të ishte i gatshëm

në dhe Bullgarinë të kufizojnë tregtinë e produkteve të tilla si gruri, misri, farat, luledielli nga



të rifillonte kufizimet nëse situata e tregut e justifikon atë", tha ai gjatë një takimi të ministrave të Financave të BE-së në Santiago de Compostela, Spanjë. Kontrollet lejuan anëtarët lindorë të BE-së, Hungarinë, Poloninë, Sllovakinë, Rumaninë

Ukraina në tregjet e tyre. Në të kaluarën, Gjermania dhe vendet e tjera të BE-së e kanë kritikuar kufizimin si dështim për të treguar solidaritet. Bullgaria vendosi të heqë kufizimet e importit të enjten.

# Denaj: 6.5 milionë euro mbështetje nga qeveria gjermane për mbrojtjen e mjedisit



Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj bëri të ditur se marrëveshja për projektin "Ekonomia qarkuluese për zhvillimin e qëndrueshëm urban në Shqipëri", i hap rrugën disbursimit të grantit të qeverisë gjermane prej 6.5 milionë euro.

Sipas ministres Denaj, marrëveshja nxit zhvillimin e një sërë instrumentesh ekonomike

në fushën e menaxhimit të mbetjeve

"Qeveria gjermane, përmes GIZ, po mbështet disa bashki në vend, duke ndihmuar në mbrojtjen dhe mbajtjen pastër të mjedisit dhe duke gjeneruar më shumë të ardhura ekonomike për komunitetin. Mbetimi të angazhuar që ky model të zgjerohet edhe në bashki të tjera", theksoi ministria.

# BB mbështetje tri shtyllave kyçe të bujqësisë

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural po punon intensivisht për të jetësuar marrëveshjen e arritur me Bankën Botërore, financimin strategjik prej 65 milionë euro në

MBZHR bën të ditur se, tri shtylla kyçe të bujqësisë, që do të mbështeten fuqishëm përmes këtij instrumenti të ri financiar për një bujqësi të qëndrueshme, gjithëpërfshirëse

Nga zbatimi i këtij projekti fermerët e vegjël do të përfillojnë nga kjo mbështetje për të lehtësuar daljen e prodhimit në treg duke shkurtuar zinxhirët tregtarë kombëtarë dhe ndërkombëtarë.

Gjithashtu 23 mijë hektarë toka bujqësore do të kenë ujtime efikase në Divjakë, Konispol e më gjerë, përmes financimit në zgjerimin e rrjetit të ujitjes dhe kullimit duke përdorur metodat dhe teknologjitë më inovative dhe efektive, të cilat do të rrisin eficiencën dhe ulin ndjeshëm kostot e administrimit të hidrovoreve.

Ndërkohë, investime transformuese në fuqizimin e sigurisë ushqimore, përmes rehabilitimit të infrastrukturës dhe laboratorëve ushqimore në pikat kufitare të doganës së Bllatës, Kakavijës, Kapshticës, Qafë Botës, Qafë Thanës dhe Vlorës do të rrisin standardet e prodhimeve shqiptare.



mbështetje të bujqësisë shqiptare dhe fermerëve të vegjël, fuqizimit të sigurisë ushqimore dhe investime transformuese në infrastrukturën e ujitje-kullimit.

e konkurruese, instrumenti i cilat u miratuan me vendim të Këshillit të Ministrave në muajin korrik për ta ratifikuar në parlament në javët në vijim.

# Shkencëtarët kinezë parashikojnë 10 % zgjerim të tokës së thatë në nivel global deri në vitin 2100

Shkencëtarët kanë parashikuar një reduktim të madh të ruajtjes së ujit tokësor në 70 vitet e ardhshme, shoqëruar me një zgjerim të tokave të thata globale deri në rreth 10 për qind, bëri të ditur Akademia Kineze e Shkencave (CAS).

Reduktimi i ruajtjes së ujit dominohet nga ndryshueshmëria e reshjeve dhe avullimit dhe mund të arrijë në 41 deri në 84 për qind deri në vitin 2100, bëhet e ditur në studimin e botuar në revistën "Climate and Atmospheric Science", citon "Xinhua".

Për të kuptuar reagimin e ruajtjes së ujit tokësor ndaj rritjes së bimësisë së tokës së thatë, një ekip kërkimor nga Instituti i Kërkimeve të Informacionit të Hapësirës Ajrore nën Akademisë Kineze të Shkencave kreu studimin bazuar në vëzhgimet satelitore dhe rezultatet e modelit. Ata vunë re një rritje të përgjithshme të rritjes së bimësisë nëpër tokat e thata në mbarë

botën midis viteve 1982 dhe 2016, gjatë së cilës depozitimi i

tokat e thata globale mund të zgjerohen me 4.1 deri në 10.6



ujit tokësor në këto rajone u ul. Gjetjet tregojnë një korrelacion negativ midis dy treguesve, veçanërisht në zonat e dominuara nga toka bujqësore.

Duke përdorur vëzhgimet me sensorë në distancë, simulimet e modeleve dhe metodat e mësimit të makinerive, ekipi i studiuesve parashikoi më tej se

për qind deri në vitin 2100, me një reduktim të madh në ruajtjen e ujit tokësor.

Sipas studimit, gjetjet nënvizojnë nevojën për planifikim të bashkërenduar për restaurimin e ekuilibruar ekologjik, menaxhimin bujqësor dhe shfrytëzimin e burimeve ujore.



## BUJQËSI

## Denaj me fermerët në Malësinë e Madhe: Mbështetje zhvillimit të potencialit në veri të vendit

Në Shkodër dhe në të gjithë rajonin verior të vendit, kemi ende kapitale të pa shfrytëzura dhe ne kemi shumë punë, për të zhvilluar të gjitha ato potenciale që ka bujqësia dhe ekonomia rurale këtu”.

Kështu u shpreh ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj në takimim që zhvilloi në Malësinë e Madhe, me fermerët, blegtorët dhe aktorë të tjerë që operojnë në sektorin rural, në rajonin verior të vendit.

Ministria Denaj, tha se, “ta nisësh nga Shkodra, për gjithëçka që ajo ofron, për të gjithë kapitalin natyror, që ajo ka ende të pa shfrytëzuar, por edhe kapitalin njerëzor, mendoj se është një mesazh për të treguar se sa punë ne kemi ende për të bërë, përtej nevojës për të vlerësuar edhe punën e bërë deri tani”.

Marr shkas, u shpreh Denaj, të shprehem kështu, sepse këtu ku jemi, është një shembull frymëzimi i asaj që ndodh përditë me punën e ndershme të atyre që kanë ardhur edhe nga jashtë dhe kanë sjellë kapitalet e tyre, duke investuar në liqenin e Shkodrës, në një nga agroturizmet më të bukur dhe të famshëm të zonës.

“Ky model investimi përcjell mesazhin e zhvillimit që ka ndodhur, por edhe të potencialit që është ende për t’u zhvilluar”, theksoi Denaj.

Ajo u ndal në tre mesazhe kryesore për komunitetin rural verior, teksa vlerësoi punën e palodhur dhe të përditëshme

të fermerëve, që është reflektuar në rritjen e eksporteve bujqësore, ndërsa pritisshmëritë janë përtej shifrës 1 milion euro eksporte.

“Në këtë qark, 70% e produkteve shkojnë nga ferma tek turizmi tek familjet dhe 83% e këtyre produkteve janë organike. Ky është një lajm shumë i mirë që e bën kulinarinë shqiptare të jetë një atrak-

shme, për aq kohë sa është sezoni. Nëse fermerët nuk janë të paguar mirë dhe nuk janë në skemën e sigurimeve shoqërore, bie incentive”, theksoi Denaj.

Ministria solli në vëmendje fuqinë dhe rolin e rëndësishëm të gruas në ekonominë rurale.

“60% e gjithë fuqisë në çfarë do lloj funksioni, në fushë, përpunim, prodhim

është rezultat i politikave të mbështetjes me subvencione të vazhdueshme që ka adresuar qeveria. Ne do të vazhdojmë t’ju mbështesim dhe synojmë rritjen e sipërfaqeve të mbjella me këto kultura, për të mos lënë asnjë copë tokë pa punuar dhe nxitur punësimin dhe të ardhurat nga ky aktivitet ekonomik i rëndësishëm”, theksoi Denaj.

Për sa i takon çështjes së digës, ministria informoi se, qeveria në bashkëpunim me institucionet e linjës ka punuar intensivisht për zbutjen e këtij fenomeni diktuar nga ndryshimet e klimaterike.

“MBZHR në këto 5 vitet e fundit ka punuar fort dha ka lidhur kontrata për të zgjidhur këtë çështje. Jemi në rrugën e duhur dhe po punojmë edhe me donatorët”, tha ajo.

Ministria i bëri apel fermerëve të bashkëpunojnë për zgjerimin e bashkimit për ekonomi dhe cilësi, përmes kontratave të qëndrueshme që garantojnë rritje të konkureshmërisë së prodhimit, përdorim të teknologjive të avancuara, më shumë përfitime subvencionesh dhe të ardhurash ekonomike.

Ky takim u zhvillua në kuadër të vizitës së parë që ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Anila Denaj, zhvilloi në Shkodër, pas marrjes së detyrës si ministre, ku u takua me komunitetin e peshkatarëve dhe diskutoi ecurinë e punës së tyre, parashtrimin dhe ndjekjen e problematikave me të cilat ndeshen ata.

## Denaj me peshkatarët në Shirokë: Liqeni, gjenerues punësimi, turizmi dhe zhvillimi ekonomik

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj, gjatë një vizite në Shirokë të Shkodrës u bëri thirrje peshkatarëve për të rritur bashkëpunimin me pushtetin vendor dhe qendror me qëllim forcimin

e tyre e kanë lidhur me peshkimin, nuk shërbejnë vetëm për familjet e tyre, por dhe për numrin e madh të turistëve vendas dhe të huaj, që gjatë këtij viti arritën shifra rekord”, vijoi ajo

Denaj bëri të ditura dhe



sion turistik dhe nesër vizitorët e huaj të mos vijnë vetëm për bregdetin, por të vijnë edhe për ushqimin”, tha Denaj.

Së dyti, vijoi ajo, 51 % e qytetarëve këtu, janë pronarë fermash me moshë nën 45 vjeç, shumica e tyre.

“Unë e di çështjen e fuqisë punëtore, sepse nuk i ndodh vetëm sektorit të bujqësisë, është problematikë, por ama duhet të kuptojmë që fermerët duhet të paguhen, jo në të zezë, sepse skema e sigurimeve shoqërore për fermerin janë shumë të ulta, por duhet të paguhet në mënyrë të denjë të menjëher-

është gruaja. Unë dua t’i falenderoj ato, sepse nuk është i lehtë angazhimi i gruas rurale edhe në të gjitha angazhimet e tjera familjare. Dua t’ju inkurajoj në mbështetjen e grave rurale, që ta shohim këtë si një punë të përbashkët për të gjithë bashkë”, u shpreh Denaj.

Ministria foli edhe për dy nga çështjet kryesore me të cilat përballet rajoni verior, siç është ajo e përmbytjeve gjatë sezonit të reshjeve intensive dhe zhvillimit të mëtejshëm të sektorit të bimëve mjekësore.

“Ecuria pozitive e sektorit të bimëve mjekësore,

e ekosistemit natyror dhe kthimin e kësaj pasurie natyrore në një motor gjenerimi të ekonomisë për banorët e zonës.

Ministria Denaj, u shoqërua në këtë vizitë nga ministria e Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, Elisa Spiropali, si dhe kryebashkiaku i Shkodrës Benet Beci.

“Në vizitën e parë në terren në Shirokë, së bashku me kolegen Spiropali, të mikpritur nga Kryetari i Bashkisë Benet Beci dhe përfaqësuesit e shoqatës së menaxhimit të peshkimit, biseduam mbi të gjitha problematikave që ata kanë”, bëri të ditur Denaj përmes rrjeteve sociale.

“Këta peshkatarë, që jetën

pikat mbi të cilat u diskutua me peshkatarët. “Gjatë bisedës me ta diskutuam mjaft çështje si gjuetia pa kriter, pamundësia për të krijuar njësi ekonomike për kultivimin e peshkut, si dhe heqja e rrethimeve amatore”, sqaroi Denaj.

“Ftova anëtarët e kësaj shoqate që të rrisin bashkëpunimin me pushtetin vendor, me besimin që me kryetarin shume aktiv të bashkisë, Benet Beci, liqeni i Shkodrës, si pasuri natyrore të marrë vëmendjen e duhur duke u kthyer në motor gjenerimi ekonomie për banorët e kësaj zone, por mbi të gjitha për ekosistemin tonë natyror”, përfundoi ajo.

## “Rriten shkëmbimet tregtare me Izraelin” - Balluku: Marrëveshje për lehtësimin e procedurave të biznesit për investitorët

Shkëmbimet tregtare mes Shqipërisë dhe Izraelit janë rritur në 3 vitet e fundit. Gjatë fjalës së mbajtur në forumin e biznesit Shqipëri-Izrael, zëvendëskryeministria dhe ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Belinda Balluku theksoi perspektivën e zhvillimit të mëtejshëm të bashkëpunimit mes 2 vendeve.

“Nga të dhënat që më janë referuar nga institucionet shtetërore shqiptare rezultojnë se shkëmbimet tregtare midis dy vendeve tona për vitin 2021 ishin 40 milionë euro, ndërkohë të realizuara për vitin 2022 kanë qenë 57 milionë euro. Për periudhën 6 mujore të 2023-it kemi arritur në 21 milionë euro dhe unë shpresoj që të tejkalojmë atë të vitit 2022, pasi kjo është sfida jonë. Numra më të rritur nga vitet e mëparshme, punë të tjera të mbaruara nga viti në vit, rezultate të prekshme nga viti në vit”.

Balluku bëri me dije se shumë shpejt do të firmoset një marrëveshje për të lehtësuar procedurat e të bërit biznes.

“Ne kemi arritur së bashku

ar rrugën për të gjitha bizneset izraelite që duan të investojnë në Shqipëri dhe për të gjitha këto biznese shqiptare që duan të investojnë në Izrael”.



edhe në një rezultat të shkëlqyer për të pasur një ‘government-to-government agreement’ të cilën do ta firmosim në muajt në vazhdim, duke i hapur kështu dhe duke facilitu-

Fushat ku aktualisht ka më shumë bashkëpunim janë bujqësia, energjia dhe inovacioni. Ndërkohë, që ka rritje të interesit nga bizneset izraelite edhe për fushën e infrastrukturës.

## “Në fshat 2”, MBZHR: 24 studentë do të eksplorojnë 4 fshatra duke jetuar e punuar aty për 2 javë

24 studentë do të eksplorojnë 4 fshatra duke jetuar e punuar aty për 2 javë.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural bëri të ditur se, në bashkëpunim me GIZ Albania projekti “Në fshat”, që nisi vitin e kaluar, solli për herë të parë një eksperiencë unike për studentët e UBT-së, të cilën do ta vijojmë këtë vit, nën logon “Në fshat 2” si një mundësi e shkëlqyer për të zhvilluar praktikë pune, teksa jetojnë një eksperiencë unike dhe argëtuese, gjatë së cilës mund të kontribuojnë me ide kreative për krijimin e modelit të fshatit turistik shqiptar.

“Në fshat 2” krahas mundësisë së eksplorimit përgjatë udhëtimit në zonat më të largëta të Shqipërisë, eksperiencës së jetuarit në fshat, zbulimit të shijes tradicionale do të shtrihet dhe në eksplorimin e trashëgimisë mjedisore dhe kulturore, ngritjen e kapac-

iteteve, zhvillimin dhe menaxhimin e projekteve me fokus

trat e Shqipërisë, që po marrin gjithmonë e më shumë vë-



zonat rurale, modeli i fshatit turistik shqiptar.

Sipas MBZHR-së, kjo nisimë synon të afrojë më shumë të rinjtë me fshatin dhe të shtojë kontributin e tyre duke ndërthurur projekte dhe ide zhvillimi në zonat rurale dhe fsha-

mendje në promovim jo vetëm si prodhues të sektorëve të bujqësisë dhe blegtorisë por dhe potenciale turistike.

Studentët e vitit të 3-të bachelor mund të aplikojnë deri në datën 15 shtator për t’ju bashkuar këtij udhëtimi “Në fshat 2”.



## AGROTURIZËM

# AKT, bashkëpunim me agjencinë zvicerane për eksperiencat më të mira në turizëm

Drejtues të Agjencisë Kombëtare të Turizmit, priten gjatë një vizite dyditore në Tiranë, Drejtorin e Tregjeve të Reja dhe Projekteve pranë Organizatës Zviceriane të Turizmit (Switzerland Tourism), Federico Sommaruga.

Takimet e kryesuara nga Drejtoresha e Përgjithshme e AKT Zana Çela, filluan pranë ambjenteve të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, ku ishte e pranishme dhe Herida

Duro, Drejtoreshë e Zhvillimit të Programeve të Turizmit, ku fokusi kryesor ishte tek krijimi i mundësive të reja të bashkëpunimit mes institucioneve respektive. Ky takim shërbeu gjithashtu dhe si një workshop

për stafin e AKT në kuadër të formave të reja të promovimit digjital e jo vetëm.

AMT njofton se, turizmi zhvilluar me Sommaruga pati disa vend ndalesa, duke filluar me Amfitejarin antik të Durrësit si dhe Torrën Veneciane, dy nga simbolet e rëndësishme të trashëgimisë sonë kulturore. Sommaruga u shpreh i impresionuar nga kjo vizitë dhe theksoi se trashëgimia e pasur monumentale historike e Shqipërisë duhet ruajtur dhe duhet punuar për ta vënë atë në funksion të zhvillimit të turizmit.

Më pas në Kantinën Duka, një nga modelet e suksesshme të agroturizmit, drejtori Sommaruga u njoh me shijet e ushqimit tradicional shqiptar

dhe mikpritjen e ofruar si një element i rëndësishëm i identitetit tonë.

Vizita përfundoi me një ndalesë në Resortin Meliá Durrës, ku pas bisedës së zhvilluar me Menaxherin e Përgjithshëm të këtij resorti, Juan Tunon Cifre, Drejtori Sommaruga shprehu vlerësimin e tij për këtë resort, si një nga strukturat më të mira në Europë të këtij grupi resortesh.

Agjencia Kombëtare e Turizmit shprehet besimplotë që

dhe në të ardhmen, të fitojë besimin e partnerëve të tillë të rëndësishëm si Organizata Zviceriane e Turizmit për të marrë eksperiencat më të mira të Agjencive homologe.



**Zwitzerland Tourism ka përvojë të vlefshme dhe tani po punon me autoritetet shqiptare. Federico Sommaruga, Drejtor për Tregjet e Reja dhe Projektet Speciale vizitoi Shqipërinë për të diskutuar me Agjencia Kombëtare e Turizmit dhe Drejtoreshën Zana Çela**

**Me këtë rast patëm një pritje dhe një shkëmbim me institucione dhe ekspertë të turizmit.**

Kryeministri Edi Rama ndau në rrjetet sociale një reportazh të gazetares së Deutsche Welle, Astrid Benölken, realizuar në Tiranë, kushtuar kuzhinës shqiptare, duke zbuluar se çfarë gatimesh duhet të provojnë vizitorët.

“Si destinacioni turistik me rritjen kampion, Shqipëria po konfirmohet edhe si një “parajsë ushqimi” për vizitorët e huaj”, u shpreh Rama.

“Gjiganti gjerman Deutsche Welle ka realizuar në Tiranë një reportazh për shijet e Shqipërisë, një guidë gastronomike që josh të gjithë ata që vizitojnë vendin tonë me aromën e kafesë turke, ndjesinë unike të Mesdheut që përcjell fërgesa tiranase, arapashin e jugut dhe shijen që lë gjurmë të forta në kujtime si ajo e flisë që bën veriu”, theksoi Kryeministri.

“Sot do të përpiqem të provoj shijen e Shqipërisë në vetëm 24 orë”, u shpreh gazetarja e Deutsche Welle, Astrid Benölken, në reportazhin të realizuar në Tiranë.

“Shqipëria është një parajsë e vërtetë e turizmit. Është e qartë arsyeja përse vendi

është një destinacion me rritje të shpejtë”, thekson gazetarja e Deutsche Welle.

“Është kaq e këndshme. Erëza interesante. Vendi ka disa specialitete shumë të shijshme”, thekson gazetarja e Deutsche Welle. “Sot do të përpiqem të provoj shijen e Shqipërisë në vetëm 24 orë, për të parë disa nga pjatat dhe vendet më interesante këtu në kryeqytetin shqiptar”, shprehet Benölken.

Gazetarja Benölken shoqërohet nga Linda, një guidë shqiptare që e ka udhëhequr në disa prej bareve dhe restoranteve në qendër të Tiranës, pasi di çdo gjë për gatimet shqiptare.

“Ne zakonisht hamë një mëngjes të lehtë, zakonisht kafe dhe sot ofrojmë kafe turke. 30 % që mbetet në filxhan nuk duhet ta pish sepse është llumë. Kafeja është një ndër industritë kryesore të Shqipërisë. Këtu ka një kafene për tre banorë. Pra,

ne e marrim seriozisht punën e kafesë”, shprehet Linda.

Benölken tha se “ashtu siç

një nga interpretuesit e kuzhinës shqiptare. Një nga gjërat për të cilat ai është i famshëm



mësora nga Linda, otomanët e sollën kafën në Shqipëri. Ata u larguan nga vendi, por kafja mbeti. Kafja e bluar dhe sheqeri hidhen në ujë”.

“Kthehemi përsëri tek ushqimi dhe takojmë një ndër miqtë e Lindës, Bledar Kolën,

është flija, një lloj byreku me qumësht. Flija është si të thash mbreti i gatimeve të brumit. Çdo copë e saj vihet në mënyrë të veçantë. U desh katër orë të përgatitej. Është shumë e këndshme. Është e ëmbël, ngjan me një petull, por nuk është. Është

si disa lloje petullash të mbledhura së bashku. Këtë e hani në familje apo edhe në restorante?”, pyet gazetarja Lindën.

“Është pak e rrallë ta gjeshtë në restorante. Ka shumë të ngjarë që përgatitet në shtëpi dhe kjo, sepse kërkon kohë që të përgatitet dhe një përkushtim të madh. Dhe megjithëse përbërësit janë gjëra të thjeshtë, përsëri kërkon punë për t'u përgatitur”, tregon Linda.

Në restorantin “Uragan” që është një nga vendet e shumta në Tiranë që njihet për gatimet shqiptare, Benölken provon edhe fërgesën, pjatë tradicionale e Tiranës.

Linda tregon se “fërgesa është ushqim veror. Kjo është fërgesa. Është gjizë me specë të skuqura dhe ndonjëherë i shtojmë edhe ndonjë ekstrakt dhe kemi pjatën e përkryer që ahahet në verë”.

Por, Benölken, provon edhe arapashin.

“Ky është arapashi. Bëhet

me qull me miell dhe me mish qengji. Është një ushqim më i rëndë nga sa kemi ngrënë, por është absolutisht shumë i shijshëm”, thekson Linda.

Benölken shprehet se “ka erëza interesante. Megjithatë, nuk është pjata ime e zgjedhur. Prandaj, mendoj të rri te fërgesa që është vërtet e këndshme. Megjithëse nuk është ushqimi im i zgjedhur, nëse ju pëlqen, duhet ta provoni arapashin”.

“Nëse kërkon qe ta kallon mbrëmjen me ndonjë gotë, në Tiranë ka vende për të zgjedhur. Shkuam në një bar me Lindën që ishte diçka krejt e ndryshme. Këtu, te “Komiteti”, ka shumë objekte nga gjysma e dytë e shekullit XX, atëherë kur Shqipëria deri në 1990-ën ishte një diktaturë. Komiteti ishte vendi më i mirë i hierarkisë. Rakia e bardhë ballkanike është zgjedhja më e mirë në Shqipëri. Për pak më shumë se nëntë euro, ju mund të pini nga koleksioni i fortisë. E fortë. Ka shije të raketës. Dhe është vërtet e mirë. Filimi i mbarë, gjysma e punës. Tamam si udhëtimi ynë”, tha Benölken.

## “Festa e fikut” në Roshnik, potencialet e zonës nxitje ekonomisë lokale

“Festa e Roshnikut”, ose ndryshe “Festa e fikut” mblodhi bashkë për dy ditë me radhë këtë fundjavë (8-9 shtator) fermerë e banorë të njësisë administrative Roshnik, dhe jo vetëm, në organizimin e “Festës së fikut”, një nga produktet për të cilat është e njohur kjo zonë.

Festa bëri bashkë fermerët të cilët sollën prodhimet e tyre në panairin agroturistik, si një mënyrë për të promovuar traditën, produktet, kulinarinë dhe natyrën shqiptare me potenciale për zhvillimin e ekon-

omisë lokale.

“Produktet e jashtëzakonshme të zonës, muzika, valltarët e lojërat për fëmijë, e bënë këtë festë fantastike për turistët dhe të gjithë pjesëmarrësit”, u shpreh kryetari i bashkisë Berat, Ervin Demo,

Festa e Roshnikut është një aktivitet i përvitshëm ku bëhet promovimi i produkteve të zonës. Njësia Roshnik ndodhet në territorin ku është dhe Parku Kombëtar Mali i Tomorit, i cili ka tërhequr vëmendjen e turistëve vendas dhe të huaj.



## Krifca: Privilegj të isha Ministër i Bujqësisë, mirënjohëse ndaj Kryeministrit Rama

(Vijon nga faja 4)

për zhvillimin dhe mirëqenien e familjeve dhe komuniteteve të tyre”, nënvizoi ajo.

Në fund, Krifca pati dhe një urim për pasardhësen në detyrë.

“Shumë urime dhe suksese Anilës në krye të bujqësisë, jam e bindur që do të shkëlqejë! Do të ketë mbështetjen time të pakushtëzuar në marrjen përsipër të të gjitha përgjegjësiave madhore që e presin. Objektivi i 1 miliard euro eksperte bujqësore brenda 2030 është objektivi madhor i kësaj qeverie, një objektivi që sot jemi shumë më pranë nga sa ishim

dje, e që kam bindjen e plotë, nën menaxhimin e ri, nesër do të jemi më pranë nga sa jemi sot”, theksoi Krifca.

“Së fundi, dëshiroj të bëj atë që s’kam mundur kurrë këto vite ta bëj, të falënderoj familjen time, miqtë dhe dashamirësit e mi, ata të cilët më kanë dhënë mundësinë ta kryej këtë rrugëtim pa kthyer kokën pas, duke frymëzuar rrugën time. Do të mbetem gjithnjë përkrahësja më e madhe dhe do të mbështes në çdo formë që do të mundem, transformimin e jashtëzakonshëm që ka ndodhur dhe vijon të ndodhë në bujqësinë shqiptare”, përfundon Krifca.





### SHOQATAT ANËTARE

AVALB FEDINVEST BKFSH EKR IBMA HABA AOA UPM LEAA ADAMA ABA SHGF ALBAFLOR

SHKPVF RKUK SVP MSHKM BIOADRIA PPAM SHT UOTSH KEA BIOPANT ADAD PSN

### KËSHILLAT RAJONALE

TIRANA DURRESI FIERI ELBASANI SHKODRA DIBRA

LEZHA GJIROKASTRA KORÇA BERATI VLORA KUKESI



Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar

[www.kashalbania.org](http://www.kashalbania.org)

# Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar





# KREDI E SHPEJTË MIKRO PËR ÇDO QËLLIM BIZNES APO INDIVID

**KREDI MIKRO**

deri në **2,500,000** LEKË



**FED**  
invest 

**GJITHMONË  
FINANCË SOCIALE**



## BUJQËSI

## MBZHR: Eksportet e verës u rritën me 4.5 herë gjatë 7-mujorit 2023

Vera shqiptare është një tjetër produkt që po gjen çdo ditë e më shumë terren në tregjet e huaja, kjo si rrjedhojë e investimeve që kanë bërë fabrikat dhe kujdesit që po i kushtojnë cilësisë së prodhimit.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, bën të ditur se, gjatë periudhës janar-korrik 2023, eksporti i verës, mushtit të rrushit dhe vermuthit është rritur me 4.8 herë në sasi, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Gjatë këtij 7 mujori janë eksportuar 41.5 tonë sasi nga vetëm 8.6 tonë që u eksportuan një vit më parë. Për këtë periudhë të ardhurat nga shitja e verës për eksport rezultojnë

4.5 herë më të larta, duke u regjistruar në afro 58 milionë lekë.

MBZHR po mbështet zhvillimin e sektorit që bart potenciale të mëdha për rritjen e mëtejshme të eksporteve, por edhe për të rritur konsumin e brendshëm drejt produkteve shqiptare.

Krahas mbështetjes me subvencione dhe grante së fundmi, falë një pune të madhe nga ekspertët e MBZHR-së, Shqipëria është bërë shteti i 50-të në botë i anëtarësuar në Organizatën Ndërkombëtare të Vreshtarisë dhe Verës (OIV), gjë që do t'i japë më shumë mundësi prodhuesve për të depërtuar më shumë në tregjet e huaja, për

të krijuar ura bashkëpunimi si dhe për t'u njohur me kultivarë dhe teknologji të reja të prodhimit.

Po ashtu, ligji i ri i vreshtarisë i cili hyn në fuqi në vitin 2024, do të jetë një tjetër instrument në të mirë të sektorit, i cili do të vendosë rregulla të reja, kontroll të shtuar si dhe pritet të ndikojë në rritjen e formalizimit, si problemi kryesor që vuan aktualisht sektori.

Ndërsa investimet në industrinë e përpunimit të verës me mbështetjen e programit IPARD II kanë qenë një tjetër nxitje për zhvillimin e sektorit sipas standardeve më të mira, që sot kanë sjellë dhe rritje të eksporteve të këtij sektori.

## Fermerët, investime për uljen e riskut nga dëmtimet atmosferike

Prodhimtaria e pemëve frutore në vendin tonë, është një tjetër sektor me rëndësi në fushën e bujqësisë, ku është shtuar vëmendja e fermerëve vitet e fundit.

Sipas statistikave nga MBZHR në vendin tonë kultivohen rreth 14.7 milionë rrënjë pemë frutore me një prodhim total mbi 296 mijë tonë, 11 milion hardhi me një prodhim prej 128,356 tonë dhe 1.7 milionë rrënjë agrume me një prodhim prej 55,118 tonë.

Ekspertët e bujqësisë, vërejnë se prodhimi i drufrutorëve ndryshon nga viti në vit dhe ky tregues varion në funksion të faktorëve të ndryshëm, përfshirë kushtet klimatike, investimet, teknologjinë dhe aftësinë e fermerëve.

Sot, përballimi i ndryshimeve klimatike me ndikim në prodhimin bujqësor, mbetet një sfidë e rëndësishme për fermerët.

Fermerëve ndër vite u është ardhur në ndihmë për mbrojtjen dhe prodhimin, falë skemave mbështetëse të ofruara për ta, ndërsa ekspertët e bujqësisë sugjerojnë si një zgjidhje tjetër alternative edhe sigurimin e fermave pranë një kompanie sigu-



rimi, e cila merr përsipër dëmshpërblimin në rast të dëmtimit nga fenomenet natyrore

Por sot përdorimi i rrjetave antibreshër lejon fermerët që të mbajnë një furnizim të vazhdueshëm në treg duke ulur rrezikun e humbjes së prodhimit, siguron rritjen e cilësisë, minimizimin e dëmtimit, uljen e shpenzimeve agroteknike, etj.

Kështu fermerët në Korçë, Lushnjë, Sarandë dhe Vlorë kanë shtuar investimet në mbrojtjen e prodhimit bujqësor nga risku klimaterik.

Sipas të dhënave nga drejtoritë e Bujqësisë, në total në këtë qarqe mbi 40 % e fermerëve kanë investuar krahas zgjerimit të pemëtoreve edhe në rrjetat antibreshër, për menaxhimin e riskut klimaterik në bujqësi.

## Nisin konsultimet publike për fazën e dytë të Vjosës Park Kombëtar

Pas shpalljes së Vjosës Park Kombëtar në Pranverë të këtij

Zonave të Mbrojtura.

Në një nisje të re frymëzuese



viti, grupi i ekspertëve lokalë dhe ndërkombëtarë po punojnë për fazën e dytë të parkut në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Turizmit, kompaninë e veshjeve për aktivitetet në natyrë Patagonia, IUCN (Bashkimi Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës) si dhe Agjencinë Kombëtare të

për të siguruar ruajtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të kësaj zone natyrore të pasur, ka filluar faza e dytë e projektimit të Vjosës Park Kombëtar me konsultimet publike për të përfshirë komunitetin dhe palët e interesit që ndikojnë dhe ndikohen në zonën përreth Vjosës.

Të gjitha takimet do të mba-

hen nga ora 09.00 në mëngjes deri më 14.00 në drekë në Përmet, Gjirokastër, Tepelenë dhe Vlorë duke nisur nga data 6 deri në datë 9 shtator 2023.

Konsultimet publike janë një hap i rëndësishëm drejt një procesi të drejtë gjithpërfshirës në marrjen e vendimeve të duhura për mjedisin përreth Vjosës dhe komunitetin.

Rëndësia e konsultimeve publike është e dyfishtë. Së pari, ato sigurojnë që zëri i komunitetit dhe palëve të interesuara të dëgjohej dhe të merret parasysh në hartimin e planit përfundimtar.

Ky proces promovon transparencë dhe përgjegjshmëri në mënyrën se si projekti do të zhvillohet. Së dyti, konsultimet publike ndihmojnë në identifikimin e çështjeve dhe shqetësimeve të ndryshme që mund të lindin gjatë implementimit të projektit, duke lejuar për përmirësime në fazën fillestare të planifikimit.

## Prodhimi i domates në vend, trend i eksportit

Sipas të dhënave të publikuara nga INSTAT, eksportet e prodhimeve bujqësore shqiptare kanë ardhur duke u rritur, ku kultura e domates vijon të mbajë vendin e parë.

Në gjysmën e parë të vitit

janë eksportuar 39,5 mijë tonë domate, në vendet e rajonit dhe më tej në Evropë.

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR) përmes programit IPARD II ka mbështetur sektorin e kultivi-

mit të frutave dhe perimeve në vend, me qëllim rritjen e rendimentit dhe standardeve, për konsumatorët vendas dhe eksport, ku janë nënshkruar 281 kontrata, me një vlerë granti prej 44,1 milionë euro.

**Prodhimi i domates në vend, trend i eksportit!**

Sipas të dhënave të publikuara nga INSTAT, eksportet e prodhimeve bujqësore shqiptare kanë ardhur duke u rritur, ku kultura e domates vijon të mbajë vendin e parë. Në gjysmën e parë të vitit janë eksportuar 39,5 mijë ton domate, në Evropë dhe vendet e rajonit.

AZHBR përmes programit IPARD II ka mbështetur sektorin e kultivimit të frutave dhe perimeve në vend, me qëllim rritjen e rendimentit dhe standardeve, për konsumatorët vendas dhe eksport, ku janë nënshkruar 281 kontrata, me një vlerë granti prej 44,1 MLN Euro.

## Sarandopori, mrekullia e Kolonjës - Llixhat me vlera të rralla kurative

E gjithë zona e Kolonjës fsheh në gjirin e saj vende të bukura dhe piktoreske që janë kthyer në destinacione të rëndësishme turistike.

Një nga këto vende janë edhe Llixhat e Sarandoporit, të cilat ndodhen vetëm 10 minuta larg Leskovikut.

Natyra mahnitëse që shihet në këtë vend nuk ka të krahasuar dhe duhet të jesh aty për ta përjetuar dhe shijuar.

I gjithë ambienti të jep qetësi, me gjelbërimin përreth, e me mënyrën e veçantë që natyra ka krijuar në Sarandopor.

Ujërat termale e kurative i japin akoma më tepër magji këtij vendi të veçantë. Uji që del aty është shumë i pastër, por më i rëndësishëm mbetet fakti se ky ujë kuron sëmundje të brendshme, ato të lëkurës, dhe ka një veprim çudibërës edhe për sëmundjet e kockave.

Vetë fakti që shumë turistë zgjedhin ta vizitojnë këtë kanton kaq të mrekullueshëm, do të thotë shumë për zhvillimin turistik në të gjithë zonën.

Është fat për Kolonjën të këtë vend atraktiv, njëkohësisht edhe me vlera të rralla kurative që çdo ditë e më tepër po afron vizitorët nga qytete të ndryshme të Shqipërisë por edhe nga e gjithë

bota.

"Këtu janë të paktën gjashtë burime termale, kryesisht sulfurore, dhe kanë vlera të jashtëzakonshme kurative. Banorët e zonës i përdorin shpesh. Kemi edhe vendbu-

Gjatë bisedave me disa prej tyre kemi marrë këto mendime lidhur me përshtypjet që kanë krijuar sapo kanë parë peizazhin e mrekullueshëm të Llixhave.

Llixhat e Sarandoporit janë



rimet të tjera pranë tre urave, që kanë qenë llixha që në kohën e Austro-Hungarisë, sepse janë austriakët të parë që janë marrë me studimin dhe evidentimin e këtyre vendeve termale," thotë një ekspert.

Shumë turistë e kanë zgjedhur pikërisht Sarandoporin, për shkak se nuk është vend i promovuar mjaftueshëm dhe që kërkon një vëmendje të madhe nga të gjithë për zhvillimin e turizmit në zonë.

monument natyror, me burimet termale që ndodhen në brigjet e Vjosës.

Turistët aty mund të gjejnë dy burime të mëdha dhe 40 burime të vogla me vlera kurative.

Padyshim një perlë natyrore, me vlerat kurative për shëndetin dhe me qetësinë që të gjithë kemi nevojë gjatë ditëve të ngrohta, por njëkohësisht edhe larg monotonisë së përditshme.



# Kina, Hi Tech në Tokën e Qytetërimit të Lashtë

## Shqipëria në Rrugën e Mëndafshit

Shqipëria nënshkroi gjatë pjesëmarrjes në forumin “Një brez, një rrugë” në maj të vitit 2017, Memorandumin e Bashkëpunimit mes 2 shteteve, me fokus forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit në fushat e transportit, infrastrukturës dhe aspektin financiar. Memorandumi u nënshkrua nga ministri i Transportit dhe Infrastrukturës, Sokol Dervishaj dhe Drejtori i Komitetit Kombëtar për Zhvillim dhe Reforma, He Lifeng.

Kështu në këtë proces të rëndësishëm bën pjesë edhe Shqipëria, me firmosjen e Memorandumit të Bashkëpunimit me palën kineze për këtë nisim. Ky memorandum shënon mënyrën sesi do të funksionojë marrëdhënia e vendit, sidomos me financuesit duke filluar nga Kina, por edhe nga bankat e ndryshme që i janë bashkuar këtij procesi me projekte konkrete.

Memorandumi i bashkëpunimit, përmban 7 pika, si fuqizimi ekonomik i dy vendeve, forcimi i bashkëpunimit në aspektet e zhvillimit të infrastrukturës, transportit etj.

## Niveli i marrëdhënieve me Kinën

Investimet e akumuluaru kineze në Shqipëri janë dyzetfishuar, duke u rritur nga më pak se 20 milionë USD në vitin 2014, në më shumë se 800 milionë USD në fund të vitit 2017. Në vitin 2018, Shqipëria ka hequr vizat për turistët kinezë gjatë sezonit turistik dhe numri i turistëve kinezë që kanë vizituar Shqipërinë është rritur prej 64%, krahasur me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Shkëmbimet midis institucioneve ligjvënese dhe partive të dy vendeve janë aktive, duke u bërë platforma e rëndësishme për rritjen e komunikimit dhe mesimit reciprok, për nxitjen e bashkëpunimit me interesa të ndërsjellta dhe për trashëgiminë e miqësisë tradicionale.

Shkëmbimet njerëzore dhe kulturore janë në zhvillim e sipër, me një prirje të mirë të ndërveprimeve. Është nënshkruar marrëveshja për vendosjen e Qendrës Kulturore Kineze në Shqipëri, e cila do të bëhet një skenë më e gjerë për shkëmbime kulturore. Rrjeti i mesimit të kinezishtes në Shqipëri dhe ai i mesimit të shqipese në Kinë po zgjerohen ditë pas dite. Universitetet e dy vendeve kanë nënshkruar shumë dokumente bashkëpunimi, duke çuar shkëmbimet mes tyre në rrugën e re.

## Seminari për Teknologjitë e Transmetimit

Disa nga vendet e përfshira në nisim të re “Një brez, një Rrugë” ishin pjesëmarrëse në

seminarin e organizuar nga Qendra e Trajnimeve Ndërkombëtare në Pekin “On Radio, Television and Video Broadcasting Technologies for Belt and Road Countries”. Seminari i konceptuar në formën e leksioneve nga autoritetet në fushën e teknologjisë, transmetimit audio-vizual, të inteligjencës artificiale, historisë dhe kulturës kineze rezultoi të ishte formati i duhur për të mësuar



më shumë në lidhje me zhvillimet e fundit teknologjike në këtë vend, që tashmë po përjeton rritje të jashtëzakonshme në këtë drejtim.

Në seminar përveç termave profesionalë, pjesëmarrësit mësuan sesi në Kinë gjithçka kryhej me pagesë online përmes telefonave smart, shërbimet jepeshin në të njëjtën mënyrë duke skanuar kodin përkatës në telefon, blerjet ishin shumë të thjeshta përmes telefonit të lidhur me llogarinë bankare.

Historia e qytetërimit të lashtë kinez ishte në fokus të disa leksioneve ku u shpalosën zhvillimet kryesore ndërsa dinastitë pasonin njëra-tjetrën dhe i linin Kinës një trashëgimi të pasur kulturore, ku Summer Palace (Pallati i Verës), Temple of Heaven (Tempulli i Parajsës) dhe Muri i Madh kinez u vizituan edhe nga pjesëmarrësit.

Seminari mbledhi pjesëmarrës nga 30 vende të ndryshme nga Europa, në Azi, Afrikë e Amerikën Qendrore. Ashtu si edhe presidenti kinez e theksoi gjatë prezantimit të nisimit, se bota mund të nxjerrë mënjëri dhe forcë nga rruga e lashtë e mëndafshit, e cila përmban shpirtin e paqes dhe bashkëpunimit, hapjen dhe përfshirjen, të mësuarit reciprok dhe përfitimin reciprok, ashtu edhe pjesëmarrësit në seminar mësuan dhe ndihmuan njëri-tjetrin, ndërkohë që u formuan miqësi dhe bashkëpunime.

## Thesaret e trashëgimisë kulturore të Kinës

Kina është një vend ku

bashkëjetojnë 65 grupe të ndryshme etnike e kulturore të cilat e kanë pasuruar secila trashëgiminë e saj në 5 mijë vjeçare. Tre vendndodhje në Pekin, mes shumë të tjerash, tërheqin vëmendjen e miliona vizitorëve nga e gjithë bota, duke i kthyer në thesare jo vetëm të trashëgimisë por edhe të turizmit.

Pallati i Verës është një ansambël i pafund liqenesh,

dhe dizenjimit të peizazhit ndërkohë që ka pasur ndikim të madh në arkitekturën dhe planifikimin në Lindjen e Largët për shumë shekuj me radhë.

Format karakteristike të arkitekturës që tregojnë mënyrë të veçantë për kulturë kineze ngrihen të madhërisht mes një kopshti të madh që tashmë përdoret për shërbime. Jashtë pjesës së mbrojtur të tempullit të moshuarit kinezë, tashmë



kopshtesh dhe pallatesh në Pekin, dikur kopsht perandorak në dinastinë Qing i përbërë nga Kodra e Jetëgjatësisë, Liqeni Kunming dhe 17 ura të shenjta. Kopshti shtrihet në 2.9 kilometra katrorë, tre të katërtat e të cilave janë ujë. Pallati i Verës është pjesë e trashëgimisë botërore të UNESCO-s prej vitit 1998.

Guidat lokale tregojnë se kopshti u ndërtua nga perandori me rastin e 60-vjetorit të lindjes së nënës së tij dhe liqeni është në formën e pjeshës, një frut që simbolizon jetëgjatësinë. Nëna e perandorit e pëlqeu shumë kopshtin dhe pallatin e saj dhe jetoi shumë vite të tjera duke e shijuar atë. Vetë perandori jetoi deri në moshë të shtyrë dhe kinezët në traditën e tyre thonë se nëse silllesh mirë me nënën, të shtohet jeta.

Në Pallatin e Verës mund të kalosh të gjithë ditën dhe nuk e sheh dot të gjithin. Peizazhi natyror me kodra dhe ujë përzier me pavjone, salla, pallate, tempuj e ura duke formuar një ansambël harmonik me vlera të padiskutueshme estetike.

## Tempulli i Parajsës

Tempulli i Parajsës është një kompleks ndërtesash fetare perandorake që ndodhet në qendër të Pekinit. Kompleksi vizitohej nga perandorët e dinastive Ming dhe Qing për ceremonitë e përvitshme të lutjeve për të korra të mbara. Tempulli u shpall trashëgimi botërore në vitin 1998 dhe përshkruhet si një kryevepër e arkitekturës

në pension, mblidhen për të ushtruar sporte të ndryshme dhe për t'u shoqëruar me njëri-tjetrin si formë e të qenurit aktiv dhe të shëndetshëm. Shumë prej tyre vallëzojnë në grupe me muzikë tradicionale duke tërhequr edhe vëmendjen e vizitorëve që bëhen pjesë e këtyre aktivitetëve.

## Muri i Madh Kinez

Muri i Madh Kinez është një seri fortifikimesh që u ndërtuan përgjatë kufijve historikë veriorë të shteteve të lashta kineze dhe Kinës Perandorake si mbrojtje kundër grupeve të ndryshme nomade nga stepat e EuroAzisë. Muri u ndërtua me radhë nga disa dinasti dhe për ndërtimin e tij u sakrifikuara jetët e miliona njerëzve. Disa pjesë të murit u ndërtuan që në shekullin e 7 para erës sonë, ndërsa seksioni më i njohur i murit u ndërtua nga dinastia Ming.

Së bashku, muri shtrihet nga Liaodong në lindja në perëndim, përgjatë një harku që vijëzon kufijtë e stepave mongole, me gjatësi 21,196.18 km në total. Sot, sistemi mbrojtës i Murit të Madh njihet si një nga ndërtimet arkitekturore më impresive në histori.

Të ngjitesh Murin e Madh Kinez je një hero, thuhet në traditën kineze, por po ashtu njerëzit tregojnë përlësi dhe respekt pasi miliona njerëz janë varrosur aty gjatë ndërtimit të tij. Panorama që shfaqet nga njëra fortifikatë në tjetrën është e jashtëzakonshme ndërsa kodrat e gjelbëruara shfaqen

njëra pas tjetrës në sfondin e shkëmbinjeve kërcënues. Ngjitja e murit është ritual për njerëzit, pasi mes shumë turistëve edhe shumë vendas, madje edhe me fëmijë, ngjisin shkallët në një eksperiencë të lodhshme por që në fund ia vlen.

## Harbin, qyteti i diversitetit

Sapo zbritet në Harbin, së pari mrekullohesh me qiellin e kaltër dhe erën e freskët edhe në ditët më të nxehta të gushtit. Qyteti ruan gjurmët e një historie të pasur me shumë shtresa të njëpasnjëshme, të ruajtura nga vendasit dhe nga autoritetet.

Kryeqendër e provincës Heilongjiang Harbin është një prej 100 zonave urbane më të mëdha në botë. Emri i tij në gjuhën mançure do të thotë “një vend për tharjen e rrjetave të peshkimit”, por Harbin u rrit nga një vendbanim i vogël rural në një nga qytetet më të mëdha të Kinës Veriore. Themeluar në vitin 1898 me ardhjen e Hekurudhës Kineze Lindore, së pari qyteti prosperoi si një rajon i banuar nga shumicë dërrmuese e emigrantëve nga Perandoria Ruse e gjurmë të kësaj periudhe gjenden kudo në qytet. Në vitet 1920, qyteti konsiderohej si kryeqyteti i modës në Kinë pasi modellet e reja vinin nga Parisi dhe Moskës përpara se të arrinin në Shanghai.

I njohur për dimra të ashpër, Harbin kurorëzohet si “Qyteti i Akullit” për shkak të turizmit dimëror dhe atrakcioneve, i njohur për festivalin e skulpturave të akullit.

Qyteti nga ana tjetër, si një nga zonat e para të çliruara në Luftën e Dytë Botërore, njihet edhe si vendi i parë ku u zbatua reforma e tokës. Dëshmi dhe dokumente të kësaj reforme ruhen në muzetë e qytetit.

Katedralja e Shën Sofisë pranë lagjes tregtare ruse ngrihet e mrekullueshme në qendër të qytetit. Ajo konsiderohet si vepër arti monumentale dhe është kisha më e madhe ortodokse në Lindjen e Largët.

## Përdorimi i teknologjisë

Vizitat në disa rrjete radio-televizive në Harbin ishin qershia mbi tortë për grupin. Teknologjitë e avancuara në transmetim, përdorimi i inteligjencës artificiale në gjuhën e shenjave, studiot e mirëpajisura dhe produktet e larmishme të platformave televizive ndezën kuriozitet për të mësuar më shumë.

Teknologjitë e reja të transmetimit kanë transformuar mënyrën e jetesës në këtë vend, ku platformat e ndryshme shërbajnë jo vetëm për të marrë informacion por edhe për shërbime dhe gjithashtu, blerje apo funksione të tjera. Përdorimi i teknologjisë ka arritur shtrirje të gjerë në popullsi, ndërsa po dalin ngadalë jashtë funksionit rrjetet kabllorë.



# China, High Tech in the Land of Ancient Civilization

When talking about China, geographically quite far from Albania on the Asian continent, many people in our country think of the images of the Albanian-Chinese friendship during the communist era, but also the goods imported by traders for the popular markets. Then to these images are added the international news on the television screens where China is reported as a superpower, with an economic boom and interesting developments in the latest technology. All these create a distant perception of this country, even though relations with China have always been present, trade exchanges have continued and a small Chinese community lives and works in Albania.

When you are first invited to China, the idea of traveling far and to an unknown world fills you with shyness. When you arrive in Beijing, the shyness disappears as this city is one of the safest metropolises to travel to, and the urban landscape does not differ much from that of other cities of million inhabitants.

Beijing surprises you with the vibrations of a modern lifestyle, sleek infrastructure with the endless skyscrapers of the city, wide and functional roads, reasonable traffic. The streets are lively but not crowded as one might expect in a city of more than 21 million people. The shopping streets are full of people who also frequent the restaurants and cafes. Chinese food, famous all over the world, does not disappoint you, you just have to get used to the slightly sweet taste of cooking.

## New Silk Road Initiative

Since 2017, China has undertaken the initiative to revive the ancient and historic trade route with Europe, the Silk Road, an initiative that is projected as one of the largest infrastructure plans of the 21st century, where the economies of the whole world will have their benefits.

The Silk Road project includes roads, highways, sea lanes, ports, power grids, financial institutions and fiber optic cables from Singapore in the north, through Malaysia and Vietnam, passing west into China's Xinjiang province, then into Central Asia and Pakistan, connecting to the oil fields of Iran, the Middle East and Africa, to follow the rail and port connection from London to Colombo to Jakarta.

This project, launched in 2013, aims to increase connectivity and economic development across 60 countries.

The initiative aims to increase cooperation between peoples and benefits for all countries involved.

## Albania on the Silk Road

During the participation in the forum "One Belt, One Road" in May 2017, Albania signed the Memorandum of Cooperation between the two countries, with a focus on further strengthening cooperation in the fields of transport, infrastructure and the financial aspect. The memorandum was signed

tries are active, becoming an important platform for increasing communication and mutual learning, for promoting cooperation with mutual interests and for inheriting traditional friendship.

Human and cultural exchanges are ongoing, with a good trend of interactions. The agreement was signed for the establishment of the Chinese Cultural Center in

linked to the bank account.

The history of ancient Chinese civilization was the focus of several lectures where key developments unfolded as dynasties succeeded each other and left China a rich cultural heritage, with the Summer Palace, Temple of Heaven and the Great Wall of China also visited by participants.

The seminar gathered participants from 30 different coun-

symbolizes longevity. The emperor's mother was very fond of her garden and palace, and lived many more years enjoying it. The emperor himself lived to a very advanced age, and the Chinese in their tradition say that if you treat your mother well, you will live longer.

You can spend the whole day in the Summer Palace and you can't see everything. The natural landscape with hills and water is mixed with pavilions, halls, palaces, temples and bridges, forming a harmonious ensemble with indisputable aesthetic values.

## Temple of Heaven

The Temple of Heaven is a complex of imperial religious buildings located in the center of Beijing. The complex was visited by emperors of the Ming and Qing dynasties for annual ceremonies praying for good harvests. The temple was declared a world heritage site in 1998, and is described as a masterpiece of architecture and landscape design, while having a major influence on architecture and planning in the Far East for many centuries.

Characteristic forms of architecture that immediately point to Chinese culture stand majestically amidst a large garden that is now used for services. Outside the protected part of the temple, the elderly Chinese, now retired, gather to practice various sports and socialize with each other as a form of being active and healthy. Many of them dance in groups with traditional music, attracting the attention of visitors who become part of these activities.

## Great Chinese wall

The Great Wall of China is a series of fortifications that were built along the historical northern borders of the ancient Chinese states and Imperial China as a defense against various nomadic groups from the steppes of Eurasia. The wall was built successively by several dynasties and the lives of millions of people were sacrificed for its construction. Some parts of the wall were built as early as the 7th century BC, while the most famous section of the wall was built by the Ming Dynasty.

Altogether, the wall stretches from Liaodong east to west, along an arc that delineates the borders of the Mongolian steppes, with a total length of 21,196.18 km. Today, the defensive system of the Great Wall is recognized as one of the most impressive architectural constructions in history.

"Climbing the Great Wall of China, you are a hero", says Chinese tradition, but people also show humility and respect as millions of people

were buried there during its construction. The panorama that appears from one fortification to another is extraordinary as the green hills appear one after the other against the background of the menacing cliffs. Climbing the wall is a ritual for people, as among many tourists, many locals, even with children, climb the stairs in a tiring but ultimately worthwhile experience.

## Harbin, the city of diversity

As soon as you land in Harbin, you first marvel at the blue sky and the cool breeze even on the hottest days of August. The city preserves the traces of a rich history with many successive layers, preserved by the locals and by the authorities.

The capital of Heilongjiang Province, Harbin is one of the 100 largest urban areas in the world. Its name means "a place for drying fishing nets" in Manchu, but Harbin grew from a small rural settlement to one of the largest cities in Northern China. Founded in 1898 with the arrival of the Chinese Eastern Railway, the city first prospered as a region inhabited by the vast majority of immigrants from the Russian Empire and traces of this period can be found everywhere in the city. In the 1920s, the city was considered the fashion capital of China as new designs from Paris and Moscow came here before reaching Shanghai.

Known for harsh winters, Harbin is crowned as the "Ice City" due to its winter tourism and attractions, known for its ice sculpture festival.

The city, on the other hand, as one of the first areas liberated in the Second World War, is also known as the first place where land reform was implemented. Evidence and documents of this reform are preserved in the city's museums.

Saint Sophia Cathedral near the Russian shopping district rises magnificently in the center of the city. It is considered a monumental work of art and is the largest Orthodox church in the Far East.

## Use of technology

Visits to several radio and television networks in Harbin were the icing on the cake for the group. Advanced technologies in broadcasting, the use of artificial intelligence in sign language, well-equipped studios and diverse products of television platforms sparked curiosity to learn more.

New broadcasting technologies have transformed the way of life in this country, where different platforms serve not only to receive information but also for services, purchases or other functions as well. The use of technology has reached a wide spread in the population, while the cable networks are slowly going out of service.



by the Minister of Transport and Infrastructure, Sokol Dervishaj and the Director of the National Committee for Development and Reform He Lifeng.

